

Ky buxhet është i dy ekstremeve, i varfërisë, i papunësisë, i padijes, i paushqyerjes dhe nga ana tjetër i luksit pa fre. Ky është buxheti më i zyrtë i miratuar në këto vite, është pasqyra e krizës së thellë dhe varfërisë së skajshme, pasqyra e paaftësisë dhe klientelizmit në menaxhimin e financave dhe pasurive publike. Flisni këtu për faturë sociale. A e dini se cila është fatura sociale e këtij buxheti? Është borxhi, sepse fatura e borxhit është më e madhe se shpenzimet për arsim, shëndetësi dhe jetë normale të qytetarëve. Fytyra e buxhetit tuaj është fytyra e borxhit. Dikush nga ju këtu mund të thotë se edhe vendet e pasura kanë borxh të lartë publik, por dallimi qëndron te përdorimi i parave që kanë marrë borxh. Ju i përdorini për PPP-të korruptive, për tenderë me fitues të paracaktuar, ndërsa vendet e zhvilluara financojnë projekte që i kthejnë investimet në 2, 3 deri në 4-fish. Këtu bëhet dallimi mes një qeverie të përgjegjshme dhe një qeverie të frymës së grabitjes. Ne kemi me javë të tera nëpër komisione që tregojmë, që gjykojmë dhe që argumentojmë padrejtësinë e qeverisë në këtë paketë fiskale ndaj qytetarëve, ndërsa ju vazhduat pa ndryshim dhe erdhët këtu me buxhetin e borxhit dhe paketën financiare klienteliste.

Ne na akuzoni se ju prishim qetësinë e aferave dhe bëjmë politikë me varfërinë, dakord, harrojeni për një moment opozitën. A e dëgjuat se si mori dhenë thirrja në fundjave e ipeshkëve të Kishës Katolike për rishikimin e buxhetit? Ngritën alarmin se varfëria është ulur këmbëkryq dhe po përhapet si tumor në çdo familje shqiptare. Kjo është kambana e radhës në veshët tuaj të shurdhër qeveritarë. Zëri i butë i tyre u dëgjua larg në të gjithë Shqipërinë, ishte thirrja e zemrës për ndjeshmëri ndaj njerëzve në nevojë ekstreme. Të nderuar qytetarë, Unë jam këtu si përfaqësuese e banorëve të qarkut të Dibrës. Dëshpërimi është i madh kur përfaqëson pikërisht zonat më të varfra siç janë Mati e Bulqiza dhe në tërësi Dibra. Askund më fort se në Bulqizë nuk vihet re kontrasti midis pasurive natyrore dhe varfërisë së njerëzve të thjeshtë. Qarku që unë përfaqësoj është një fakt i patjetërsueshëm që vërteton babëzinë. Zona ime ka njerëz punëtorë dhe besnikë, të cilët punojnë në bujqësi, në miniera, por vazhdojnë të jenë njerëzit me më shumë halle. Bulqiza është e pasur me krom, pyje e ujëra, por prej tyre përfiton vetëm një grusht i vogël oligarkësh. Mijëra minatorë rrezikojnë jetën çdo ditë për të nxjerrë pandalshëm kromin që pasuron tjetërkënd dhe pagat e tyre janë qesharake në krahasim me sakrificën. Nëse do të kishin alternativë tjetër pune me pagë shumë më të ulët, shumë prej tyre deklarojnë se nuk do ta preferonin minierën, duke ndier në çdo moment rrezikun për jetën. Me dhjetëra minatorë humbasin jetën në galeritë famëkeqe të tmerrit e të frikës, ndërkohë që shfrytëzohen dhe mbeten me muaj të tërë pa paga, minatorëve u mungon edhe kujdesi minimal shëndetësor e social. Spitali i Bulqizës, i cili duhet të ishte në pararojë të shërbimit shëndetësor për heronjtë e nëntokës është katandisur në një infermieri të thjeshtë. Besoj se duhet të jemi rasti i vetëm në Europë që moshën e daljes në pension të plotë për minatorët e kemi 65 vjeç.

Ky buxhet duhet të kishte një plan të parë për miratimin e statusit të minatorit, por për fat të keq anashkalohet, nuk lejohet të diskutohet për këtë çështje dhe ndërkohë minatorët vuajnë thellë e më thellë në hallin e tyre. Të dalë ministri i linjës e të na deklarojë sot se çfarë do të bëhet me statusin e minatorit. Renta minerare nuk i akordohet qytetit të Bulqizës. Në qarkun ku unë jam zgjedhur, ndryshe nga sa propagandohet nga mëngjesi deri në darkë nga qeveria e koncesioneve, ka zero investime në rrugë dhe mungon uji i pijshëm. Nuk ka paradoks më të madh sesa qarku që ka pasuri të pafundme në nëntokë, të ndodhet në atë gjendje që është sot. Rruga, shembulli i së keqes, Qafë BuallKrastë, 17 kilometra dhe ajo që është e dukshme në këtë rrugë nuk është asfalti, por në çdo kilometër një lapidar, pasi aksidentet në këtë rrugë janë të vazhdueshme për shkak se është totalisht e shkatërruar. Në

Bulqizë përfitojnë ndihmë ekonomike 1700 familje, të cilat duhet të mbajnë frymën gjallë me më pak se gjysmën e të ardhurave që do t'i takonin vetëm një njeriu nëse do të miratohej minimumi jetik. Kam kërkuar të dija për miratimin e minimumit jetik në dëgjesat për buxhetin, por na u tha se raporti i Avokatit të Popullit, i cili ka publikuar minimumin jetik prej 17 mijë lekë, nuk vlen. Kërkova në dëgjesa në Komisionin e Ligjeve, të dija përse nuk investohet në mirëmbajtjen e akseve kryesore ekzistuese, Milot-Burrel dhe Rrëshen-Burrel, por edhe për këtë kishte përgjigje. Gjasat tregojnë që po lihen qëllimisht të shkatërrohen alternativat e tjera, që dibranët të jenë të detyruar të udhëtojnë në Rrugën e Arbrit me pagesë, pasi pyetja ime nëse do të ketë taksë kalimi Rruga e Arbrit nuk u mohua nga ministria. A mundet të më citoni çfarë investimesh do të ketë në Dibër,- ishte një pyetje tjetër imja, për të cilën përsëri nuk mora përgjigje.

Nuk ka përgjigje, për rrugët dhe ujin. Në Dibër nuk ka investime për rrugët tashmë prej vitesh, nuk mundet të përmendet një rrugë rurale në të gjithë qarkun. Unë përmenda rrugën e Krastës dhe Martaneshit, por i gjithë qarku ka këtë problem. Tashmë ka rrugë si ajo e Macukullit, Derjanit dhe Rukajt, që nuk kanë asnjë shpresë për të hedhur edhe një lopate asfalt. E rinia vrapon e vrapon drejt vendeve të Europës, një rini që shikon njëra-tjetrën keq e më keq dhe, nga ana tjetër, shikon qeverinë që nuk pyet për të. Shqiptarët prekin e jetojnë një Shqipëri tjetër. Jetojnë Shqipërinë anemike, ku 51 për qind e popullsisë vuan nga varfëria. Kushdo e kupton se kjo është shenjë papërgjegjshmërie. Shqipëria është sot anemike, sepse është e papunë, sepse investimet janë në rënie, sepse po zhytet në borxhe. Ky tregues duhet ta detyrojë qeverinë që minimumi jetik dhe duhet pranuar, duhet shpallur, duhet njohur nga qeveria dhe nga parlamenti dhe më pas duhet bërë një program pune për uljen graduale të varfërisë. Qeveria do t'i duhet të rishikojë politikat sociale që mbështesin shtresat në nevojë. Nuk ka përgjigje për ish-të përndjekurit, për ish-pronarët, por parashikime qesharake për këto shtresa, dhe luks për zyrat e makinat e qeveritarëve. Korrupsioni po nënshton shtetin tonë 110 vjeçar, po varfëron një vend, po pasuron një pushtet.

Raportet e KLSH në vite për abuzime e dëm ekonomik, shkelje procedurave të prokurimeve, abuzimi me buxhetin e shtetit, me pasuritë publike tregojnë qartë këtë gjendje ku jemi sot. “Ka shumë mënyra për ta vrarë një njeri”, - thotë Brehti, pra ta godasësh fizikisht, t'i heqësh bukën e gojës, të mos i trajtosh sëmundjen, ta zhytësh në varfëri, ta bësh të punojë derisa të këputet së lodhuri, ta shtysh në vetëvrasje. Fatkeqësisht vetëm e para është e dënueshme nga shteti ynë. Shteti juaj që nuk meriton as votë dhe as respekt. Çdo ditë në përpjekje për t'ju larguar sa më parë, do të na keni këtu përballë. Faleminderit!